

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i Specializuar i Hysni Gucatit

Data: 25 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Kërkesë për Udhëzime në lidhje me Procedurën e Rishikimit të Paraburgimit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Hysni Gucatit

Jonatan Elistan Ris QC

Hju Bauden

Mbrojtësi i Nasim Haradinajt

Bastian Martens

I. KONTEKSTI

1. Në urdhrin e datës 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake informoi z. Gucati dhe të bashkëdyshuarin, z. Haradinaj ("të dyshuarit") se ZPS-ja kishte dorëzuar një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* ("Aktakuza") kundër tyre¹.
2. Kjo ishte në vijim të deklarimit publik të synimit të ZPS-së gjatë seancës së datës 1 tetor 2020 për të dorëzuar parashtrim kundër të dyshuarve brenda fundit të muajit tetor 2020².
3. Në paragrafin 10 të këtij urdhri, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vërente se³:
 - (a) z. Gucati është arrestuar tashmë dhe vijon të mbahet në paraburgim;
 - (b) sidoqoftë z. Gucati nuk është në dijeni të akuzave konkrete kundër tij në aktakuzë; dhe se
 - (c) z. Gucati ka të drejtë t'i jepet i gjithë informacioni thelbësor, për të qenë në gjendje të ketë rishikim efektiv të paraburgimit.
4. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake deklaroi se⁴:

¹ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, "Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës ", 11 nëntor 2020, konfidencial, para 5.

² KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, publik, f.15

³ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës paraprake, "Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës ", 11 nëntor 2020, konfidencial, para 10.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00065, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, "Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës ", 11 nëntor 2020, konfidencial, para 11.

“... është i prirë që, në rrethanat e konkrete të kësaj çështjeje, ta bëjë Aktakuzën të disponueshme për të dyshuarit, me redaktimet e nevojshme. Më tej, nëse dëshirojnë, për hir të drejtësisë ata mund të bëjnë gjithashtu parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Kjo nuk e paragjykon ushtrimin e të drejtave nga të dyshuarit sipas Ligjit dhe Rregullores”.

5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kërkoi palëve që të bënin parashtrime për këtë temë, brenda datës 17 nëntor 2020.
6. Parashtrimet në emër të zotit Gucati⁵, të zotit Haradinaj⁶ dhe të Prokurorit të Specializuar⁷ u dorëzuan më 17 nëntor 2020, sipas urdhrit.

II. . KËRKESË PËR UDHËZIME TË MËTEJSHME NË LIDHJE ME PROCEDURËN E RISHIKIMIT TË PARABURGIMIT

7. Z. Gucati mbahet në paraburgim tashmë prej saktësisht 2 muajsh, duke filluar prej arrestimit të tij më 25 shtator 2020.
8. Në përputhje me rregullën 57 të Rregullores, paraburgimi i zotit Gucati do të rishikohet të paktën çdo dy muaj, siç e informoi Gjykatësi i Vetëm drejtpërdrejt z. Gucati në seancën e datës 1 tetor 2020⁸.
9. Në këto rrethana, Gjykatësit të Procedurës Paraprake i kërkohet që urgjentisht të japë udhëzime të mëtejshme për rishikimin e paraburgimit të z. Gucati,

⁵ KSC-BC-2020-07, F00066

⁶ KSC-BC-2020-07, F00067

⁷ KSC-BC-2020-07, F00068

⁸ KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, në faqen 26, rreshtat 18-21

përfshirë edhe nxjerrjen e aktakuzës⁹ dhe pas kësaj për shkëmbimin e parashtrimeve lidhur me rishikimin e paraburgimit.

Numri i fjalëve (në origjinal): 555 fjalë.

/nënshkrim/

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtës i Specializuar i Hysni Gucati

Hju Bauden

Bashkëmbrojtës i Specializuar i Hysni Gucati

25/11/2020

Kardif, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe

⁹ Duhet theksuar, siç ka përmendur edhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake, se z. Gucati ka të drejtë t'i jepet i gjithë informacioni thelbësor, për të qenë në gjendje të ketë rishikim efektiv të paraburgimit (përfshirë edhe ushtrimin e së drejtës për të kërkuar rishikim edhe pa përfunduar afati dymujor, në rastet kur ka ndryshim të rrethanave) – shih KSC-BC-2020-07, F00065, "Urdhër për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës", në paragrafin 10.